




2024

BULETINI

NËNTOR



Fushata “Zgjidhe Lomshin” për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me UNICEF-in e financuar nga Bashkimi Evropian, lansuan fushatën për promovimin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara me një ceremoni të mbajtur në Sheshin “Adem Jashari”. Kjo fushatë u shënuar me prezantimin e instalacionit simbolik “Lomshi”, një vepër artistike e hapur për publikun për tri ditë, që sjell në pah sfidat e përditshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara duke shërbyer si një thirrje e fortë për ndërgjegjësim dhe mbështetje ndaj tyre dhe familjeve të tyre.

Në këtë ceremoni, Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, udhëheqësja e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, znj. Veronika Vashchenko, dhe Drejtori për Shëndetësi, z. Shkëlzen Hajdin, theksuan rëndësinë e krijimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse për të përmirësuar jetesën dhe integrimin social të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke ofruar një mjedis ku ata mund të zhvillohen plotësisht.

Fushata ndërgjegjësuere “Zgjidhe Lomshin” synon të adresojë sfidat unike me të cilat përballen këta fëmijë, duke mbështetur një vizion për të ardhmen ku çdo fëmijë gëzon të drejta dhe mundësi të barabarta.



Komuna e Lipjanit në bashkëfinancim me IADK ka bërë shpërndarjen e mekanizmit bujqësor për 12 përfitues, fermer të Komunës së Lipjanit nga komuniteti jo shumicë.

Me këtë rast, Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z.Diamant Bytyqi dhe Nënkryetari për Komunitete z. Lulzim Qerimi, kanë uruar fermerët përfitues, njëherit kanë falenderuar IADK për përkrahjen duke potencuar se Komuna e Lipjanit do të vazhdoj tutje me përkrahje dhe bashkëpunime të tilla edhe në të ardhmen me qëllimin të lehtësimit në punën e tyre.

Nga ana tjetër, z. Zenel Bunjaku nga IADK falënderoi Komunën e Lipjanit për bashkëpunimin e treguar.

Në kuadër të këtij projekti, janë mbështetur gjithsej 26 fermerë, ku 11 prej tyre kanë përfitur serra me sipërfaqe prej 120 m² dhe sisteme të ujitjës me inpute përjellëse. Për fermerët e tjerë janë shpërndarë pajisje të ndryshme bujqësore, si: motokultivatorë, freza, kosa, rimorkio, spërkatesa, plugje dhe pajisje të tjera që ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit në sektorët e perimtarisë dhe blegtorisë.

Ky bashkëpunim është pjesë e projektit "Fuqizimi i komuniteteve rurale përmes zhvillimit të bujqësisë", financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe përfaqësuar nga Embassy of Sweden in Pristina. Fondet e projektit menaxhohen nga Danish Refugee Council, ndërsa zbatimi i tij do të bëhet nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (IADK).



Ambasadori i Britanisë në Kosovë Jonathan Hargreaves vizitoi Komunën e Lipjanit

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka pritur në takim Ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë z. Jonathan Hargreaves. Kryetari Ahmeti dhe ambasadori Hargreaves kanë diskutuar çështje të ndryshme por theks më të veçantë i kanë dhënë zhvillimit ekonomik në Komunën e Lipjanit, pozites së gruas në shoqëri dhe pushtetin lokal në Kosovë.

Kryetari z. Imi Ahmeti fillimisht ka falenderuar ambasadorin Hargreaves për viziten në Lipjan, duke shprehur mirënjohjen ndaj tij për kontributin dhe mbështetjen e Britanisë së Madhe ndaj Kosovës si një aleat i pazëvendësueshëm.

Ahmeti po ashtu ka informuar ambasadorin për karakteristikat e Komunës së Lipjanit dhe çështjet tjera aktuale rreth realizimit të projekteve.

Nga ana tjetër, Ambasadori Jonathan Hargreaves e falënderoi Kryetarin Ahmeti për pritjen, e njëkohësisht theksoi se mbështetja e Britanisë së Madhe në drejtim të Kosovës do të vazhdojë edhe më tutje, për të avancuar në çdo drejtim raportet mes të dyja vendeve.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka mirëpritur në zyrën e tij Fanol Shalën, Kryetar i Shoqatës së Klubit Aeronautik “Shqiponjat e Kastriotit” dhe Avni Kuqin, Kryetar i Federatës Aeronautike të Kosovës, së bashku me përfaqësues të tjerë nga fusha e aeronautikës.

Gjatë këtij takimi, u diskutua për rëndësinë e aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të “Lipjani Aero Show 2024” dhe për mbështetjen e Komunës së Lipjanit në promovimin e sporteve ajrore dhe turizmit.

Përfaqësuesit e aeronautikës i dhuruan z. Ahmeti një dhuratë simbolike në shenjë mirënjohjeje për mbështetjen e tij ndaj këtij aktiviteti.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti i shoqëruar nga Drejtori i Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale z. Shkelzen Hajdini dhe drejtori i Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan z. Agim Krasniqi, në ambientet e QKMF-së kanë pritur ambasadorin e Zvicrës në Kosovë z. Jurg Sprecher së bashku me profesor Manuel Battegay, President i Komisionit Këshilldhënës mbi bashkëpunimin Ndërkombëtar zvicrran të shoqëruar nga delegacioni SDC, SECO dhe përfaqësuesit e AQH.

Kryetari z. Imi Ahmeti fillimisht ka falenderuar ambasadorin Sprecher për viziten në Lipjan, duke shprehur mirënjohjen ndaj tij për kontributin dhe përkrahjen e shtetit të Zvicrës në Kosovë e në këtë rast në Lipjan përmes projekteve të shumta të AQH, DEMOS dhe organizatave të tjera që janë realizuar falë mbështetjes së popullit zvicërran. Ai po ashtu ka theksuar se Komuna e Lipjanit do të angazhohet në vazhdimësi që të ketë progres të qendrueshëm dhe stabil por edhe të avancoj edhe më tutje shërbimet shëndetësore.

“Natyrisht prioritetet i qeverisjes sonë lokale është shëndetësia ne jemi në përfundim të Objektivit të ri të qendrës urgjente dhe QKMF-së në Lipjan e cila do të jetë e gatshme në vitin e ardhshëm, me ndërtimin e objektivit të ri modern për shërbimet shëndetësore do të shtojmë edhe shërbimet cilësore ndaj qytetarëve”, tha ndër të tjera Kryetari Ahmeti.

Nga ana tjetër ambasadori i Zvicrës në Kosovë z. Jurg Sprecher e falënderoi Kryetarin Ahmeti dhe përfaqësuesit e tjerë komunalë për pritjen dhe bashkëpunimin, njëkohësisht theksoi se mbështetja e shtetit të Zvicrës do të vazhdoj edhe më tutje për të avancuar shëndetësinë, ku dhe njeherit ka bërë të ditur se tani më është nënshkruar edhe marrëveshja e një faze të re të bashkëpunimit me ministrinë e shëndetësisë.



Në sallën e Kuvendit Komunal në Lipjan, sot u mbajt takim pune me gratë nga zona të ndryshme, me temën: Të drejtat pronësore, procesi i regjistrimit të pronës dhe shërbimet kadastrale, si dhe lehtësimi i procesit të regjistrimit të pronës në emër të të dy bashkëshortëve.

Drejtoresha për Gjeodezi dhe Kadastër, znj. Safete Amerllahu, prezantoi të dhëna mbi procesin e regjistrimit të pronës në Komunën e Lipjanit, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së grave në këtë proces. Ajo tha se, për vite me radhë, ka pasur përmirësime të dukshme në ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi regjistrimin e përbashkët të pronës.

Aktiviteti u organizua nga Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore. Ndërsa mbështetja financiare dhe asistenca profesionale përmes ligjëratave u ofrua nga Organizata CLARD dhe KADE. Projekti PIAKOS, i zbatuar nga ATRC dhe i financuar nga Banka Botërore për vitet 2024/25, kontribuon në përgatitjen e dokumentacionit ligjor për regjistrimin dhe legalizimin e pronave për raste në nevojë.



Lipjan

Filim

Ranguar

1/33

- 2023
- 2022
- 2021
- 2020
- 2019
- 2018
- 2017
- 2016



Kuartilet

- i lartë
9 Komuna
- i mesëm i lartë
8 Komuna
- i mesëm i ulët
8 Komuna
- i ulët
8 Komuna



Rangimi



Indeksi

Problemet teknike të ueb-faqeve zyrtare të disa komunave kanë ndikuar që: Skënderaj, Pejë, Kamenica, Mitrovica e Jugut dhe Prizreni të mos jenë pjesë e llogaritjeve në raportin e indeksit të Transparencës Buxhetore për vitin 2023.

Shpërndaje




Komuna e Lipjanit vazhdon të kryesojë në transparencën buxhetore.

Në raportin e fundit të publikuar nga Instituti GAP “Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave”, Komuna e Lipjanit, me 100 pikë të grumbulluara, është renditur si komuna më transparente.

Kjo dëshmon edhe një herë se transparenca vazhdon të jetë prioriteti ynë bazik në të gjitha fushat, me theks të veçantë transparenca buxhetore, e cila rrit llogaridhënien dhe besimin në institucionet publike, si dhe ndikon në menaxhim më efikas të parasë publike.

Ne do të vazhdojmë me punë dhe transparencë.



Njoftim

Pas testimit disa ditësh të rreth-rrotullimit në rrugën Haradin Bajrami në qytetin e Lipjanit është konstatuar që për shkak të pamundësisë së zgjerimit të rrugës dhe largimit të trotuareve, ndërtimi i këtij rreth-rrotullimi do të veshtrësonte edhe më tutje qarkullimin e veturave.

Drejtoria e Infrastrukturës do të angazhohet në planifikimin e trafikut në këtë pjesë të rrugës në të ardhmen përmes vendosjes së semaforëve testues apo shenjave të trafikut me qëllim të lehtësimit të qarkullimit. Andaj, ju njoftojmë që ky rreth-rrotullim nuk do të ndërtohet dhe vendosja e shiritave dhe shenjave ishin pjesë e testimit të përkohshëm. Drejtoria për Infrastrukturë!



Komuna e Lipjanit përfituese e projektit për implementimin e masave të efijencës së energjisë në ndërtesat shumë-banesore sociale

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me Drejtorin Menaxhues të Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE), z. Driton Hetemi, kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëfinancimin e projektit për zbatimin e masave të efijencës së energjisë në Ndërtesën Banesore Sociale në Magurë.

Me këtë rast, kryetari z. Imri Ahmeti ka theksuar se, me finalizimin e kësaj marrëveshjeje, synohet përmirësimi i kushteve dhe kursimi i energjisë në Ndërtesën Shumë-Banesore Sociale në Magurë.

Komuna e Lipjanit do të bashkëfinancojë 10% të shumës totale prej 233,530.00 euro, ndërsa pjesën tjetër do ta mbulojë FKEE.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi së bashku me kryesuesin e Kuvendit të Komunës z. Daut Azemi, ishin pjesë e tryezës së rumbullakët të organizuar nga Agjencia për Ndhimë Juridike Falas në bashkëpunim me GIZ-in gjerman, ku u diskutua për shërbimet që ofron zyra për ndihmë juridike falas në Lipjan.

Në fjalën e tij, nënkryetari Bytyqi tha se me funksionalizimin e kësaj zyre po vazhdojmë një mbështetje të rëndësishme për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët, pavarësisht gjendjes së tyre financiare.

“Kjo zyrë është një mundësi që secili qytetar të marrë ndihmë juridike profesionale dhe mbështetje në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Andaj, falenderoj Agjencinë për Ndhimë Juridike Falas dhe GIZ-in për bashkëpunimin e vazhdueshëm”, është shprehur nënkryetari Bytyqi.

U.D. Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas, z. Faton Jashari, vuri në dukje nevojën e bashkëpunimit ndër-institucional mes Zyrës Mobile për Ndhimë Juridike Falas në Lipjan, akterëve komunalë dhe organizatave joqeveritare për sigurimin e qasjes në drejtësi për të gjithë qytetarët.

Zyra Mobile për Ndhimë Juridike Falas në Lipjan është e themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike pa pagesë për qytetarët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

**Në Lipjan, ju mirëpret znj. Zana Bikliçi Berbatovci
046/127-077**

**E hënë, e martë dhe e mërkurë
08:00 – 16:00**

Biblioteka e Qytetit, Lipjan, kati I



Është mbajtur takim me dy grupet e auditimit social në Komunën e Lipjanit, i realizuar nga organizata Demokraci Plus dhe Ekipe të Auditimit Social.

Në takim me përfaqësuesit e Demokraci Plus (D+) dhe ekipe të auditimit, nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, pranoi raportet me rekomandime për projektet kapitale të monitoruara. Bytyqi falënderoi qytetarët e Lipjanit për pjesëmarrjen aktive në këtë proces, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

Auditimi social u dha qytetarëve mundësinë të identifikojnë mangësitë në projektet kapitale të monitoruara. Kjo qasje ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe fuqizimin e zërit të qytetarëve, duke forcuar besimin mes qytetarëve, shoqërisë civile dhe komunës.

Projektet e monitoruara përfshijnë “Ndërtimin e Çerdhes në Rrugë të Ri faza e II” dhe “Ndërtimin e Sallës së Sporteve në Shkollën Ismail Luma” në Lipjan.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me kryetarët e këshillave të prindërve dhe drejtorët e shkollave, mori vendimin që doracakët e lëndës "Edukimi Seksual dhe Shëndeti Riprodhues" të mos zbatohen në shkollat e Komunës së Lipjanit.

Gjatë këtij takimi, Kryetari Ahmeti u shpreh qartë se doracakët e shumë përfolur nuk do të gjejnë zbatim në procesin arsimor të nxënësve, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së vlerave të familjes dhe mbrojtjes së fëmijëve nga materialet që mund të jenë të papërshtatshme.

"Ky vendim reflekton përkushtimin tonë për të siguruar që edukimi i fëmijëve të jetë në harmoni me vlerat tona familjare dhe kulturore, duke i mbrojtur ata nga përmbajtje të cilat mund të jenë të papërshtatshme për zhvillimin e tyre", tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Nga ana tjetër, drejtorët e shkollave dhe kryetarët e këshillave të prindërve shprehën qartë qëndrimin e tyre rreth kësaj lënde, duke theksuar rëndësinë e krijimit të një mjedisi arsimor të shëndetshëm për fëmijët tanë dhe potencuan se përmbajtjet që mund të jenë të papërshtatshme dhe që cenojnë vlerat tona familjare nuk duhet të jenë pjesë e shkollave tona.

Me iniciativën e drejtorëve të shkollave dhe këshillit të prindërve, u dakorduan që lënda "Edukimi Seksual dhe Shëndeti Riprodhues" të mos përfshihet në përzgjedhjen e kurrikulave me zgjedhje në të gjitha shkollat e Komunës së Lipjanit.



Komiteti për Komunitete nga Komuna e Lipjanit ka mbajtur një takim të përbashkët me Komitetin për Komunitete nga Komuna e Vushtrrisë, ku është bërë shkëmbimi i përvojave ndërmjet dy komuniteteve.

Komiteti për Komunitete ka zhvilluar takimin e 32-të me radhë dhe njëherësh takimin e parë ndërkomunal të komuniteteve në Kosovë. Gjatë këtij takimi, fokusi i diskutimeve ka qenë çështjet që lidhen me përmirësimin e kushteve dhe mbështetjen për komunitetet, si dhe mënyrat për avancimin e bashkëpunimit ndërkomunal në nivel lokal.

Ky takim është mbështetur nga OSBE-ja dhe është vlerësuar si një hap i rëndësishëm për forcimin e dialogut dhe koordinimit ndërmjet komuniteteve, me qëllim sigurimin e mundësive dhe mbështetjes më të madhe për të gjitha komunitetet në rajon.



Komuna e Lipjanit promovon programin e strehimit familjar në bashkëpunim me SOS Fshatrat e Fëmijëve

Drejtori për Shëndetësinë dhe Përkujdesjen Sociale, z. Shkelzen Hajdini, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale (QPS) dhe partneritetin e çmuar të SOS Fshatrave të Fëmijëve në Kosovë, organizoi një sesion promovues për programin e strehimit familjar.

Drejtori z. Hajdini potencoi se Komuna e Lipjanit ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm për të promovuar familjet strehuese të reja, duke inkurajuar të pranishmit të bëhen pjesë e këtij programi jetik për strehimin e fëmijëve në nevojë. Ai shprehu mirënjohje të veçantë për SOS Fshatrat e Fëmijëve për mbështetjen dhe bashkëpunimin e shkëlqyer në këtë proces.

Kjo iniciativë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së qëllimeve të përbashkëta për mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve në nevojë, duke forcuar rrjetin e familjeve strehuese në Komunën e Lipjanit.



Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Lipjanit, z. Valon Pacolli, ka pritur në takim shefin për Ekonomi dhe Punësim të Zyrës Zvicerane SDC në Kosovë, z. Jean Christophe Favre, si dhe përfaqësuesit e organizatës Swiss Contact.

Gjatë këtij takimi, z. Pacolli ka prezantuar prioritetet strategjike të Komunës së Lipjanit në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes për projektet e reja që janë në proces.

Ai shprehu mirënjohjen ndaj SDC dhe Swiss Contact për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen në realizimin e projekteve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës, me fokus të veçantë në ekonominë, zhvillimin e potencialeve të turizmit dhe inkurajimin e sektorit privat për të luajtur një rol aktiv në këtë proces.

Përfaqësuesit e SDC-së shprehën gatishmërinë për të parë nga afër realizimin dhe gjetjen e mundësive për mbështetjen e këtyre projekteve, duke theksuar rëndësinë e tyre për zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm në Komunën e Lipjanit.

Në fund të takimit, u realizua një vizitë e përbashkët në disa nga vendet me potencial të lartë për zhvillimin e turizmit, ku u shqyrtuan mundësitë e implementimit të projekteve të ardhshme.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim të veçantë legjendën e sportit shqiptar dhe botëror, z. Shaban Tërstena.

Gjatë takimit, Tërstena i dorëzoi kryetarit Ahmeti çmimin prestigjioz “Oscari i Artë Olimpik” si shenjë respekti dhe vlerësimi për angazhimin dhe përkushtimin e tij në promovimin e vlerave olimpike.

Kryetari Ahmeti e falënderoi Tërstenën për këtë nderim të jashtëzakonshëm, duke shprehur mirënjohje të thellë për këtë çmim të veçantë, të cilin e cilësoi jo vetëm si një nder personal, por edhe si një vlerë për të gjithë shqiptarët.

Shaban Tërstena, kampion olimpik dhe një nga emrat më të shquar të mundjes botërore, ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e sportit.



Diskutimi final për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Lipjanit 2024-2029

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, organizoj punëtori për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2029, një hap kyç drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përfshirjes së gjerë për të siguruar një strategji gjithëpërfshirëse dhe efektive. Ndërsa, drejtorët e drejtorive komunale diskutuan prioritetet dhe objektivat kryesore që synojnë nxitjen e rritjes ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

Ky aktivitet u mbështet nga USAID-i në kuadër të programit “Qeverisja e Pronës”.



Mbahet takimi i Këshillit Publiko-Privat në Lipjan

Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u zhvillua takimi i radhës i Këshillit Publiko-Privat, organizuar nga kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti, në bashkëpunim me programin e USAID-it "Qeverisja e Pronës".

Kryetari Ahmeti falënderoi z. Skender Krasniqi, kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës dhe znj. Jennifer Ober nga USAID, për bashkëpunimin dhe praninë e tyre në këtë takim. Ai vlerësoi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bizneseve dhe theksoi rëndësinë e dialogut të hapur për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe sektorit privat, si dhe për adresimin e nevojave dhe sfidave të bizneseve.

"Takimet e tilla ndihmojnë në diskutimin e çështjeve me interes të përbashkët dhe në forcimin e rolit të bizneseve në zhvillimin ekonomik lokal. Lipjani ka potencial të madh për biznes, falë pozicionit të favorshëm gjeografik dhe infrastrukturës së mirë," tha kryetari Ahmeti. Ai po ashtu theksoi rëndësinë e përfshirjes së bizneseve në hartimin e dokumenteve strategjike, si Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Harta Zonale dhe Plani Zhvillimor Komunal, me qëllim zhvillimin afatgjatë të tyre.

Ndërsa, z. Skender Krasniqi, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, vlerësoi përpjekjet e komunës së Lipjanit për të forcuar lidhjet me bizneset dhe nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit të përbashkët për zhvillimin ekonomik.

Në këtë takim mori pjesë edhe Drejtoresha e aktivitetit të USAID-it, Qeverisja e Pronës, znj. Jennifer Ober, e cila shprehu mbështetjen për iniciativat që promovojnë dialogun publiko-privat, duke nënvizuar se ky bashkëpunim është kyç për një sektor privat më të fortë dhe një partneritet të qëndrueshëm.




Nderohet Kryetari Ahmeti me fanellën e KV Skënderbeu

Përfaqësuesit e Klubit të Volejbollit Skënderbeu i dhuruan Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, fanellën zyrtare të klubit si shenjë mirënjohjeje për mbështetjen e tij të vazhdueshme ndaj sportit.

Gjatë takimit, kryetari Ahmeti shprehu falënderime për dhurimin e fanellës dhe ritheksoi përkushtimin e institucioneve për të mbështetur zhvillimin e klubeve sportive në Lipjan. Ai theksoi se mbështetja për sportin do të vazhdojë me qëllim arritjen e sukseseve të reja.

Përfaqësuesit e klubit falënderuan kryetarin për ndihmën dhe përkushtimin e tij, duke theksuar se mbështetja institucionale është një motivim i madh për të arritur rezultate edhe më të mira.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim delegacionin kroat të udhëhequr nga z. Zdravko Vukić, Drejtor i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Kroacisë, të shoqëruar nga znj. Krenare Sogojeva Dërmaku, Komisionere e Agjencisë për Informim dhe Privatësi në Kosovë.

Gjatë këtij takimi janë diskutuar çështje të ndryshme, por me theks të veçantë për suksesin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi – AIP, e cila ka fituar statusin e anëtares vëzhguese në Bordin Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB). Ky status është rezultat i lobimit dhe komunikimit të vazhdueshëm të të gjitha strukturave të AIP-së me përfaqësuesit e EDPB-së dhe institucioneve ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave. Rezultat i arritur me mbështetjen dhe rekomandimin e z. Zdravko Vukić, njëkohësisht Zëvendëskryesues i EDPB-së.

Kryetari, z. Imri Ahmeti, fillimisht ka falënderuar për vizitën delegacionin kroat, në krye me z. Zdravko Vukić, Drejtor i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kroaci, duke shprehur mirënjohjen ndaj tij për kontributin dhe përkrahjen në këtë proces, por edhe të shtetit të Kroacisë, i cili ka qenë gjithmonë afër popullit të Kosovës.

Nga ana tjetër, z. Zdravko Vukić, Drejtor i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Kroacisë, falënderoi Kryetarin Imri Ahmeti për pritjen dhe bashkëpunimin drejt avancimit të proceseve të shumta.

Ndërsa, znj. Krenare Sogojeva Dërmaku, Komisionere e Agjencisë për Informim dhe Privatësi në Kosovë, ka falënderuar Kryetarin Ahmeti për pritjen e këtij delegacioni, si një shenjë respekti për mbështetjen që ka ofruar për Agjencinë dhe rrjedhimisht për Republikën e Kosovës.



Në kuadër të aktiviteteve të Nëntorit, në hollin e Komunës së Lipjanit, u hap ekspozita e fotografit të njohur, Arian Mavriqi. Ekspozita përmban një koleksion të veçantë fotografish artistike, që paraqesin me mjeshtëri pasurinë e faunës së Kosovës, duke nxjerrë në pah larminë e kafshëve të egra.

Në këtë aktivitet mori pjesë Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij. Ata ndoqën nga afër ceremoninë e hapjes dhe prezantimin e mbajtur nga vetë fotografi, z. Mavriqi, i cili ndau detaje rreth procesit krijues dhe theksoi rëndësinë e fotografive të tij për ndërgjegjësimin mbi ruajtjen e faunës dhe mjedisit.



KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 31-të me radhë

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 31-të me radhë, ku u diskutuan të gjitha pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Pas prezantimeve dhe diskutimeve, anëtarët e KPF-së aprovuan dhe rekomanduan të gjitha pikat për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të premten, 29 nëntor 2024.



Të nderuar qytetarë të Komunës së Lipjanit,

Me rastin e 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ju përcjell urimet më të përzemërta.

Kjo ditë përfaqëson sakrificën, krenarinë dhe unitetin tonë, duke na rikujtuar vlerat më të larta shoqërore dhe kombëtare. Ajo na motivon të ndjekim vizionin dhe idealet e atyre që sakrifkuan gjithçka për lirinë dhe pavarësinë e kombit tonë.

Urime 28 Nëntori – Dita e Flamurit Kombëtar!

Kryetari i Komunës së Lipjanit

Imri Ahmeti



Mbahet Festivali Mbarëkombëtar i Këngës për Fëmijë “Lipjani Këndon 2024”

Në kuadër të festës së Flamurit Kombëtar, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, dhe organizuar nga Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në sallën e re të sporteve në Lipjan u zhvillua edicioni i V-të i festivalit për fëmijë, “Lipjani Këndon 2024”.

Ky festival, tashmë tradicional, mblodhi fëmijë nga treva të ndryshme shqiptare, duke u ofruar atyre një mundësi të veçantë për të shfaqur talentin dhe pasionin për këndimin .

Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Anila Reçica Llugiqi, falënderoi Kryetarin e Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, për mbështetjen e vazhdueshme që u jep aktiviteteve kulturore, duke theksuar rëndësinë e kësaj mbështetjeje për fuqizimin e brezave të rinj në fushën e artit dhe kulturës .

Në përfundim të festivalit, u ndanë çmime dhe mirënjohje për pjesëmarrësit, duke vlerësuar performancat e tyre të shkëlqyera .



Me homazhe pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, filluan aktivitetet e ditës së sotme për nder të Festës së 28 Nëntorit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, z. Daut Azemi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vendosi buqeta me lule pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në nderim të 112-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.



Old-timer-at zbukurojnë sheshin “Adem Jashari” në Lipjan për Festën e 28 Nëntorit

Në kuadër të aktiviteteve për nder të Festës së 28 Nëntorit, sheshi “Adem Jashari” në qytetin e Lipjanit u shndërrua në një skenë festive, falë parakalimit të veturave të vjetra “old-timer”.

Atmosfera unike e krijuar nga këto automjete klasike tërhoqi vëmendjen e qytetarëve, duke sjellë një kombinim mes nostalgjisë dhe krenimit. Ky aktivitet i veçantë jo vetëm që zbukuroi qytetin, por gjithashtu tërhoqi entuziastët e veturave klasike, duke e bërë festën edhe më të veçantë.



Me ftesë të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka marrë pjesë në ceremoninë festive me rastin e Ditës së Flamurit Kombëtar dhe 112-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, që u zhvillua në Tiranë.

Kjo vizitë është një mundësi e mirë për thellimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve shqiptare, duke nderuar historinë dhe vlerat që bashkojnë kombin shqiptar.



Drejtori i Arsimit në Komunën e Lipjanit, z. Rasim Hasani, ka pritur në takim nxënësit e ShFMU “Vëllezërit Frashëri”, të cilët janë shpallur fitues në Panairin e Garave ASEF, të mbajtur në Tiranë.

Drejtori Hasani ka përgëzuar nxënësit dhe mësimdhënësit për arritjet e tyre, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes institucionale për zhvillimin dhe promovimin e arsimit cilësor.

Ndërsa drejtori i shkollës, z. Jakup Bahtiri, së bashku me nxënësit, ka shprehur falënderime për mbështetjen e vazhdueshme të Komunës së Lipjanit në aktivitetet dhe garat ndërkombëtare.

Në edicionin e këtij viti të Panairit ASEF, nxënësit e ShFMU “Vëllezërit Frashëri” përfaqësuan denjësisht Kosovën, duke arritur rezultate të shkëlqyera. Në Gjeografi, ata u shpallën fitues të vendit të parë dhe u nderuan me medalje të artë , ndërsa në Histori siguruan dy vende të dyta.



U mbajt mbledhja e 35-të me radhë e Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 35-të me radhë, ku u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës, të cilat ishin propozuar për këtë seancë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me Nënkryetarin, z. Diamant Bytyqi, gjatë kësaj seance kanë dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Gjatë punimeve të kësaj seance, u miratuan këto pika të rendit të ditës:

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 34-të e Kuvendit.

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK - Lipjan. (Rishqyrtim).

Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit 2024-2029.


Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr.15-462/01-35825 datë 25.07.2024 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.

Propozim Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme - lokaleve afariste të Komunës në ZK Magurë.

Diskutimi i Planit të veprimit për adresim të rekomandimeve të ZKA nga Raporti vjetor për PVF 2023.

Diskutimi i Raportit të Auditorit të Brendshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve për auditimin e kryer në sektorin e tatimit në pronë.

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë